



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.16/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit S.Sh., nga Prizreni, ndaj gjyqtares N.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr.1500/22, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.21.09.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit S.Sh., nga Prizreni, ndaj gjyqtares N.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr. 1500/22.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës S.Sh., nga Prizreni ka parashtruar Ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj gjyqtares N.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr. 1500/22, Kjo ankesë nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prizren si Kërkesë për shqyrtim të çështjes disiplinore për shkak të padrejtësisë, subjektivizmit dhe njëanshmërisë nga ana e gjyqtares N.B.,.

Ankuesja S.Sh., nga Prizreni ka parashtruar Parashtresë për njoftim lidhur me padrejtësitë , subjektivizmin dhe anshmërinë e gjyqtares N.B., në lëndën C.nr. 1500/22 dhe ka kërkuar që të iniciohet procedura disiplinore ndaj të njëjtës pasi që e njëjta ka shkelur ligjin, ka shkelur Kodin e Etikës profesionale duke tejkaluar kompetencat e veta në mënyrë arbitrare ka vendosur në lëndën e lartcekur. Sipas ankueses gjyqtarja N.B., me dt. 05.05.2022 ka pranuar një Padi me propozim për caktimin e Masës së përkohshme të sigurisë dhe e njëjta me cit. 13.05.2022 ka marr Aktvendim duke aprovuar Masën e përkohshme në mënyrë arbitrare pa caktuar seancë. Në vazhdim S.Sh., ka përshkruar gjendjen faktike të lëndës sipas padisë ku është realizuar kontrata mbi shitblerjen e pronës në mes te R.Sh., bashkëshorti i S.Sh., dhe palëve tjerë në kontest e cila shitblerje është realizuar ne mënyrë ligjore tek Noteri me të gjitha elementet plotësuese të realizimit. Bazuar ne këtë gjyqtarja e çështjes me veprimet e veta dhe caktimin e Masës se përkohshme te sigurimit ka

prejudikuar çështjen, nuk ka dhënë arsytim për caktimin e masës së sigurisë dhe nuk ka respektuar të drejtat ligjore dhe procedurale të LPK-së bazuar në nenin 456 për palën e paditur -Me këtë ka shkelur Etikën e gjyqtarit dhe çështjen e ka vendosur me subjektivizëm dhe anshmëri . Prandaj ka propozuar që të iniciohet procedura disiplinore ndaj gjyqtarës për shkeljet e lartcekura dhe të ndërmerren masat ndaj të njëjtës për shkelje të rëndë të detyrave të punës , për subjektivizëm dhe anshmëri.

Gjyqtarja N.B., në deklaratën e saj në lidhje me pretendimet e ankuesit ka cekur se pranë kësaj gjykate është parashtruar padia e paditësve A.M., D.A., dhe T.A., të cilët i përfaqëson përfaqësuesja ligjore A.M., që të gjithë nga fshati Lubinje e Poshtme , Komuna e Prizrenit dhe të cilët i përfaqëson me autorizim av. S.V., Prizreni , kundër të paditurave Sh.A., fsh. Lubinje e Poshtme , Komuna e Prizrenit të cilën e përfaqëson av. Y.K., nga Prizreni dhe S.Sh., nga Prizreni të cilën me autorizim e përfaqëson av. H.S., nga Prizreni për shkak të vërtetimit të pronësisë në baze të trashëgimisë. Së bashku me padi paditësit kanë parashtruar edhe propozim për masën e përkohshme. Pas pranimit të lëndës gjyqtarja në kuptim të nenit 306.1 të LPK-së ka marr aktvendim C.nr. 1500/2022 me dt. 13.05.2022 me të cilën ka aprovuar propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit pasi që ka konstatuar se janë plotësuar kushtet nga neni 297 të LPK —se. Ky aktvendim është ekspeduar të gjithë palëve dhe e paditura, këtë parashtruesja e kërkesës për iniciim të procedurës disiplinore e ka pranuar me dt. 09.06.2022 dhe ndaj të njëjti nuk ka parashtruar kundërshtim ashtu si e parasheh ligji, në afat prej 3 dite nga dita e pranimit të Aktvendimit të cilin e kundërshtojnë. Gjyqtarja konsideron se në veprimet e saja nuk ka shkelje pasi që sipas nenit 306 par. I të LPK-se parashihet se gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurisë pa njoftim dhe pa dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit nëse propozuesi i sigurimit e bëne të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit. Sa i përket faktit se Aktvendimi nuk ka arsytim këtë pretendim pala e pakënaqur mund të parashtrtojë në kundërshtim si është paraparë me nenin 306.2 të LPK-së me ç rast gjykata është e obliguar të hap seancë dëgjimore si dhe të vlerëson pretendimet e palëve në procedurë gjë që pala e paditur nuk e ka bere. Gjyqtarja konsideron se veprime e saj janë bazuar në nenin 297 dhe 306 të LPK-se dhe se nuk ka pasur shkelje të Etikës dhe se këtë lëndë e ka trajtuar me përgjegjësi dhe me profesionalizëm pa subjektivizëm dhe anshmëri.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar Ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj gjyqtarës N.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr.1500/22, drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarre disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bere shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes N.B., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës CM. 1500/2022. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Ankuesja ka parashtruar Parashtruesë për njoftim lidhur me padrejtësitë , subjektivizmin dhe anshmërinë e gjyqtarës N.B., në lëndën C.nr. 1500/22 dhe ka kërkuar që të iniciohet procedura disiplinore ndaj të njëjtës pasi që e njëjta ka shkelur ligjin , ka shkelur Kodin e Etikës profesionale duke tejkalluar kompetencat e veta në mënyrë arbitrare ka vendosur në lëndën e lartcekur. Pas verifikimit dhe analizës së shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese Autoriteti Kompetent ka vërtetuar se pranë kësaj gjykate është parashtruar padia e paditësve A.M., D.A., dhe

T.A., të cilët i përfaqëson përfaqësuesja ligjore A.M., që të gjithë nga fshati Lubinje e Poshtme, Komuna e Prizrenit dhe të cilët i përfaqëson me autorizim av. S.V., nga Prizreni, kundër të paditurave Sh.A., nga fsh. Lubinje e Poshtme , Komuna e Prizrenit të cilën e përfaqëson av. Y.K., nga Prizreni dhe S.Sh., nga Prizreni të cilën me autorizim e përfaqëson av. H.S., nga Prizreni për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë. Së bashku me padi kanë parashtruar edhe propozim për masën e përkohshme. Gjyqtarja pasi që ka pranuar këtë padi ka vendosur lidhur me Propozimin e caktimit të masës së përkohshme me aktvendim C.nr. 1500/2022 me cit. 13.05.2022 pa caktuar seancë dëgjimore në kuptim të nenit 306.1 të LPK-së . Ndaj këtij Aktvendimi palët e paditur nuk kanë parashtruar kundërshtim ashtu si është paraparë me nenin 306.2 të LPK-së. Me rastin e fillimit të procedurës palët e paditur nuk kanë pasur avokat , por të njëjtit kanë angazhuar avokat pasi që kanë pranuar Aktvendimin për përgjigje në padi . E paditura S.Sh., ka angazhuar avokatin H.S., me dt. 18.04.2023 kurse e paditura Sh.A., ka angazhuar avokatin Y.K., me dt. 10.02.2023. Që të dy avokatë kanë parashtruar përgjigje në padi.

Autoriteti Kompetent konsideron se gjyqtarja i ka ndërmarr veprimet të cilat janë të parapara me prioritet, pra ka vendosur për propozim të masës së sigurisë në afatin ligjor, kurse për pjesën tjetër të kërkesëpadisë do të vendosi sipas radhës. Sa i përket Masës së përkohshme të sigurisë të cilën gjyqtarja ka caktuar pa caktuar seancë dëgjimore këtë gjyqtarja e ka bërë në kuptim të nenit 306.1 të LPK i cili në mënyrë shpërthimore parasheh ;" Me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit" . Pra në rastin konkret gjyqtarja ka vepruar në përputhje me ligjin kur e ka caktuar Masën e sigurisë të cilën pala e paditur e ka pranuar në mënyrë të rregullt dhe në afatin ligjor dhe nuk ka parashtruar Kundërshtim si është paraparë me nenin 306.2 ku ceket ; "Vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni gjykata ia dërgon kundërshtarit të sigurimit menjëherë. Kundërshtari i sigurimit brenda afatit prej tre (3) ditësh në përgjigjen e tij mund t'i kontestojë shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e pas kësaj gjykata duhet të caktojë seancë në tri ditët e ardhshme. Përgjigja e kundërshtarit të sigurimit duhet të përmbajë pjesën arsyetues "

Duhet të ceket se çështja sipas padisë në lëndën C.nr. 1500/22 është në fillim të procedurës dhe caktimi i masës së përkohshme të sigurisë nuk është vendim meritore , por masë për siguri të gjendjes faktike dhe se në shqyrtime të cilat do të mbahen dhe do të caktohen nga ana e gjyqtarës do të vendoset në mënyrë meritore për këtë çështje.

Sipas Planit Strategjik për Përmirësim të Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë përcaktuar se cilat lëndë kanë prioritet në punë giatë këtij viti, si lëndë me prioritet lëndët më të vjetra se 2(dy) vjet, lëndët e kthyer në rigjykim, lëndët e dhunës në familje, Propozimet për masën e përkohshme, lëndët civile statusore. Pjesa që ka të bëjë me prioritet, respektivisht për Propozim për masën e sigurisë është vendosur sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore , nuk ka pasur arbitraritet, subjektivizëm dhe njëanshmëri andaj si Autoritet Kompetent konsideroj se gjyqtarja N.B., në veprimet e saja nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.16/23, me dt. 21.09.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk e paraparë e drejta e ankesës.